



**VENDIM**  
**Nr.34 Datë 21.04.2010**

**PËR**  
**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË**  
**“C & S CONSTRUCTION ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.04.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C & S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, te kesaj shoqërie

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “C & S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) eshte plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “C & S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Rapuni 1 dhe HEC Rapuni 2.
2. Shoqëria të fillojë ushtrimin e aktivitetit për prodhimin e energjisë elektrike në përputhje me afatet e përcaktuara në Kontraten e Koncesionit.
3. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



---

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,  
**VENDIMIN**  
*Nr. 34 Datë 21.04.2010*

**PËR**  
**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË**  
**“C & S CONSTRUCTION ENERGY” SH.P.K.**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Bujar Nepravishta

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Entela Shehaj

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Ardian Haçi

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Abaz Aliko

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Shkëlqim Bozgo

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_